

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**« SADION » shpk**

Sot me date 01 Korrik 2019 ( dymije e nentembedhjte ), ditën e hene, ne ortaket e shoqerise :

1. **SAIMIR JAUPAJ**, me atesi Meto dhe amesi Valentina, i datelindjes 09.08.1992, lindur ne Fier dhe banues ne Qytetin e Fierit, Rajoni nr. 1, Qarku Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjoftimit me numer personal J20809083W ;
2. **METO JAUPAJ**, me atesi Sadik dhe amesi Shaqe, i datelindjes 17.02.1959, lindur ne Patos, Fier dhe banues ne Qytetin e Fierit, Rajoni nr. 1, Qarku Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjoftimit me numer personal F90217011F ;
3. **VALENTINA JAUPAJ**, me atesi Ago dhe amesi Shaze, e datelindjes 06.02.1971, lindur ne Kash, Fier dhe banuese ne Qytetin e Fierit, Rajoni nr. 1, Qarku Fier, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetase shqiptare, mbajtese e leternjoftimit me numer personal H15206065V ;
4. **DIONELA OSMANI**, me atesi Agim dhe amesi Behare, e datelindjes 30.04.1993, lindur ne Lenie, Gramsh dhe banuese ne Valias i Ri, Bashkia Kamez, Qarku Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetase shqiptar, mbajtes e leternjoftimit me numer personal J35430105A;

bazuar ne ligjin 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare",

**Vendosem**

Krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar « SADION » shpk dhe hartimin e Statutit te Shoqerise, ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ".

**NENI 1**  
**EMERTIMI I SHOQERISE**


- ❖ Shoqeria Tregtare do te quhet Shoqeria « SADION » shpk.

**NENI 2**  
**FORMA E SHOQERISE**

- ❖ Shoqeria « SADION » shpk eshte e llojit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, e krijuar dhe zoteruar nga ne Ortaket e saj: SAIMIR JAUPAJ, METO JAUPAJ, VALENTINA JAUPAJ dhe DIONELA OSMANI

**NENI 3**  
**QENDRA ( SELIA ) E SHOQERISE**

- ❖ Shoqeria « SADION » shpk do te kete qendren ( seline ) e saj ne ne adresen: Tirane, Rruga e Kavajes, Qendra e Biznesit GKAM, Bashkia Tirane, Qarku Tirane.



- ❖ Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Ortakeve te Shoqerise.
- ❖ Me vendim te ortakeve Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra te tjera perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 4**  
**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

- ❖ Shoqeria « SADION » shpk do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 10 vjet.
- ❖ Me vendim te Ortakeve te Shoqerise ky afat mund te jete me i shkurter apo mund te zgjatet me tej.

**NENI 5**  
**REGJIMI JURIDIK**

- ❖ Ne te gjithë territorin e saj ne Republikën e Shqipërisë, Shoqeria do te udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- ❖ Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- ❖ Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi dhe kerkesat e pergjithshme te kontabilitetit, sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.
- ❖ Shoqeria gezon afirmimin ligjor qe nga dita e rregjistrimit te saj ne Q.K.B.

**NENI 6**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

- Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :
  - a. Veprimtari e kembimit valutor ( EXCHANGE ).
  - b. Ushtrimi i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar jobanke " AK Invest ";
  - c. Veprimtari e agentit per sherbimin e pagesave te ndryshme per llogari te te treteve, ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke.
  - d. Veprimtari te tjera te natyres financiare te lejuara nga ligji.
- Me vendim te ortakeve Shoqeria mund te shtoje apo pakesoje ne cdo kohe objektin e veprimtarise se saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 7**  
**KAPITALI I SHOQERISE**

- ❖ Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 2.000.000 ( dymilione ) leke, i barabarte me 4 ( kater ) kuota me nga 500.000 ( peseqind mije ) leke secila.
- ❖ Kapitali fillestar i ndare ne perqindje midis ortakeve te shoqerise do te jete si me poshte :
  - SAIMIR JAUPAJ – 25 ( njezet e pese ) % = 1 ( nje ) kuota = 500.000 leke ;
  - METO JAUPAJ – 25 ( njezet e pese ) % = 1 ( nje ) kuota = 500.000 leke ;
  - VALENTINA JAUPAJ – 25 ( njezet e pese ) % = 1 ( nje ) kuota = 500.000 leke ;
  - DIONELA OSMANI – 25 ( njezet e pese ) % = 1 ( nje ) kuota = 500.000 leke ;



- ❖ Keto kuota jane teresisht prone e Ortakeve te Shoqerise dhe do te depozitohen si kapital themeltar i Shoqerise « SADION » shpk ne Banken e Nivelit te Dyte " BKT " pas rregjistrimit te shoqerise ne QKB.
- ❖ Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te shoqerise si dhe transferimi i kuotave te shoqerise do te behet ne perputhje me me legjislacionin perkates qe rregullon veprimtarine e kesaj shoqerie dhe me dispozitat perkatese te statutit te kesaj shoqerie.
- ❖ Kuotat e shoqerise mund te tranferohen lirisht midis ortakeve te shoqerise, te cilet gezojne te drejten e parablerjes te kuotave qe do te tjetersohen.
- ❖ Gjithashtu ato mund te transferohen ne favor te personave te trete me ane te kontrates se shitjes, dhurimit apo me cdo menyre tjeter te njohur nga legjislacioni ne fuqi. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kjo duhet bere me akt noterial dhe te regjistrohet prane organeve kompetente qe rregullojne veprimtarine e shoqerive tregtare.
- ❖ Ne rast vdekjeje te Ortakeve te Shoqerise, pasuria u kalon trashegimtareve te tyre sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

### NENI 8

#### ORGANET E SHOQERISE

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE TE SHOQERISE KOMPETENCAT E SAJ

- ❖ Kompetencat kryesore te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve do te jene :
  1. Te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise .
  2. Te percaktoje politikat tregtare te shoqerise.  
Te beje ndryshime ne statutin e shoqerise.
  3. Te emeroje dhe shkarkoje administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar.
  4. Te mbikeqyre zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise se veprimtarise.
  5. Te miratoje pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise.
  6. Te miratoje zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
  7. Te riorganizoje ose te mbylle shoqerine.
  8. Te emeroje dhe te shkarkoje nga detyra personelin e shoqerise dhe tu percaktoje shperblimin qe do u jepet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
  9. Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise, ajo do te vendose zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik .

### NENI 9

#### ADMINISTRATORI I SHOQERISE, KOMPETENCAT E TIJ

- ❖ Shoqeria « SADION » shpk do te udhehiqet, administrohet dhe drejtohet nga Administratori i shoqerise **Z. SAIMIR JAUPAJ**, me atesi Meto dhe amesi Valentina, i datelindjes 09.08.1992, lindur ne Fier dhe banues ne Qytetin e Fierit, Rajoni nr. 1, Qarku Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjoftimit me numer personal J20809083W , njekohesisht njeri prej ortakeve te shoqerise, per nje periudhe 5 ( pese ) vjecare, me te drejte rizgjedhjeje, i cilido te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet.
- ❖ Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise mund te caktoje nje ose disa persona te tjere si administratore te saj, te cilet duhet te regjistrohen si te tille prane Qendres Kombetare te Biznesit.








➤ Administratori ka të drejte e detyrohet te:

1. kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqërise, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Ortaket e Shoqerise ;
2. perfaqeson shoqerine tregtare ne marrëdhëniet me te tretet, si dhe para te gjitha organeve shteterore;
3. kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel te shoqerise;
4. pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se veprimtarisë dhe ua paraqet Ortakeve te Shoqerise per miratim;
5. Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet legjislacionin ne fuqi ;
6. Raporton ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe veprimtarine e shoqerise tregtare;

❖ Per cdo ceshtje profesionale, juridike, ekonomike, teknike, etj, shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkohshme, duke punesuar specialiste sipas legjislacionit ne fuqi.

#### NENI 10 DISPOZITAT EKONOMIKE

- ❖ Veprimtaria ekonomike – financiare dhe tregtare e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqiperise .
- ❖ Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregetar dhe juridik me persona te trete shoqeria pergjigjet me pasurite e veta .
- ❖ Aktivi dhe pasivi i veprimtarise se Shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike – financiare dhe tregtare te saj te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj .
- ❖ Pasurite e shoqerise vleresohen nepermjet bilanceve ekonomiko- financiare dhe tregtare te saj , ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .
- ❖ Te ardhurat e shoqerise pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se paluajtshme dhe te luajtshme si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interes te shoqerise, i takojne ortakeve te saj sipas dispozitave te percaktuara ne aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj .
- ❖ Per detyrimet shoqeria pergjigjet me fondet e veta .
- ❖ Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikës si dhe ne institute te tjera private ekzistuese, apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .
- ❖ Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Ortaket e Shoqerise .

#### NENI 11 LLOGARIA E SHOQERISE

- ❖ Shoqeria llogarine rrjedhese te saj e ka ne disa Banka te Shqiperise. Ajo mund te cele edhe llogari te tjera rrjedhese ne banka te ndryshme, ne Euro dhe dollare Amerikane.
- ❖ Shoqeria i mban llogarite ne leke shqiptare ose ne valute te huaj, sipas rastit qe i paraqitet per veprime te ndryshme monetare.
- ❖ Te gjitha shpenzimet e shoqerise ne leke apo ne valute sigurohen nga arketimet e sherbimeve dhe veprimeve qe pasqyrohen ne Objektin e veprimtarise se saj, ose nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni ne fuqi ne Republikën e Shqiperise .

#### NENI 12 VITI EKONOMIK



- ❖ Viti ekonomik fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon ne 31 Dhjetor te atij viti.

### NENI 13

#### DHENIA E LLOGARISE EKONOMIKE

- ❖ Shoqeria funksionon ne baze te dispozitave ligjore ekonomike ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, te dispozitave te Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj, si dhe programeve te vecanta qe do te hartojme ne Ortaket e saj per cdo vit ekonomik.
- ❖ Llogaria ekonomike e shoqërisë mbështetet ne llogaritë e shërbimeve dhe te vetfinancimeve qe mbulon shpenzimet e veta .
- ❖ Shoqeria do te mbaje kontabilitet ne baze te rregullave , metodave teknike kontabel ne gjuhen shqipe dhe ne leke shqiptare .Per mbajtjen e kontabilitetit do te perdoren Libri Ditar, Libri i Madh , Libri Inventar etj .
- ❖ Cdo forme organizimi e kontabilitetit do te mbahet e tille qe te mundesoje kryerjen e kontrollit te jashtem ne menyre te tille qe cdo ekspert kontabel te nxjerre nga librat kontabel nje pamje te pergjitheshme te veprimeve te kryera dhe veprimtarise se shoqërisë .

### NENI 14

#### RAPORTI VJETOR

- ❖ Raporti vjetor i veprimtarise se shoqërisë do te paraqitet ne formen dhe permbajtjen e percaktuar ne ligjin NR 9901 , Dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregëtare".

### NENI 15

#### RASTET E NDERPRERJES SE VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

- ❖ Ne ortaket e shoqërisë kemi te drejten e nderprerjes se marredhenieve qe rrjedhin nga Statuti dhe Akti i Themelimit te Shoqërisë kur per kete vertetohen arsye serioze sic mund te jene :
  1. Veprimi i kushteve te forcave madhore
  2. Varferimi i shoqërisë
  3. Dalja e nje vendimi nga Organet kompetente qe ndalon veprimtarine e saj .
  4. Marrja e vendimit perkates nga Ortaket e shoqërisë .

### NENI 16

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- Ne rast se ne Republikën e Shqipërisë shpallen ligje, dekrete, ose vendoset nje politike me e favorshme nga legjislacioni i pasqyruar ne Aktin dhe Statutin e krijimit te Shoqërisë, atehere ne ortaket e saj kemi te drejten ti drejtohem organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem per ne dhe shoqërine e krijuar prej nesh.

### NENI 17

#### ZGJIDHJA E MOSMAREVESHJEVE

- ❖ Zgjidhja e mosmareveshjeve midis personave te ndryshem dhe shoqërisë do te behet me mirekuptim, e nese kjo nuk arrihet atehere pala e interesuar mund ti drejtohet organeve kompetente te juridiksionit te vendit ku kane lindur mosmarreshjet .



**NENI 18**  
**DISPOZITA TE VECANTA**

- ❖ Te gjitha dokumentat e shoqerise do te permbajne adresen e plote te saj, numrin e rregjistrimit ne Rregjistrin e QKB, si dhe Numrin e Rregjistrimit ne Organin Tatimor te njesise ku do te ushtroje veprimtarine e saj .
- ❖ Per ceshtje te tilla qe nuk parashikohen ne Statut, veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne Fuqi ne Republiken e Shqiperise .

**NENI 19**  
**HYRJA NE FUQI**

- ❖ Ky Statut i perpiluar nga ne Ortaket e Shoqerise, ne kater kopje te barabarta, hyn ne fuqi qysh ne momentin e nenshkrimimit nga ana jone dhe rregjistrimit te tij prane QKB-se.
- ❖ Ne rastet e likujdimit perfundimtar te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi, pushon se vepruari edhe ky Statut i saj .
- ❖ Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit tregtar si dhe te ecurise se veprimtarise se shoqerise, ne Ortaket e Shoqerise kemi te drejten e permiresimit te metejshem te dispozitave te ketij Statuti dhe te te gjithe dokumentave te Shoqerise, duke bere depozitimet perkatese sipas legjislacionit ne fuqi .

Statuti i mesiperm u nenshkrua nga ne ortaket e shoqerise sot me date 01.07.2019

**ORTAKET E SHOQERISE**

**SAIMIR JAUPAJ**

*Saimir Jaupaj*  
*Jaupaj*

**METO JAUPAJ**

*Meto Jaupaj*  
*Jaupaj*

**VALENTINA JAUPAJ**

*Valentina Jaupaj*  
*Jaupaj*

**DIONELA OSMANI**

*Dionela Osmani*  
*Osmani*